

TEWHIDI DHE RENDI POLITIK *

Tevhidi mbron parimin se “Ky *ummet* i juaji është i vetmi *ummet*, Zot i të cilit është All-llahu. Prandaj, adhuroje dhe shërbeji Atij!”.¹ Se besimtarët vërtet janë një vëllazëri e vetme, anëtarët e së cilës e duan njëri-tjetrin në emër të Zotit, të cilët e këshillojnë njëri-tjetrin në drejtësi dhe durim,² të cilët gjithë së bashku, pa përjashtim, ngjiten për litarin e Zotit dhe nuk përçahen,³ të cilët kujtojnë për njëri-tjetrin duke urdhëruar të mirën dhe duke penguar nga e keqja,⁴ të cilët, përfundimisht, i binden Zotit dhe Pejgamberit të Tij,⁵ e gjithë kjo e tregon rëndësinë e *tevhidit* ndaj shoqërisë.

Vizioni i *ummetit* është një, të tilla janë edhe ndjenjat a vullneti si dhe veprimi i tij. Ekziston një konsensus në mendimin, vendimin, qëndrimin, karakterin dhe armët e anëtarëve të *ummetit*. *Ummetit* është një rend njerëzish i përbërë prej një konsensusi trepalësh: mendjes, zemrës dhe armëve. Ai është një vëllazëri universale e cila nuk njeh as identitetin racor, as atë etnik. Sipas tij, të gjithë njerëzit janë një dhe vlerësohen vetëm sipas përkushtimit e devotshmërisë.⁶ Në qoftë se ndonjëri prej anëtarëve të tij fiton dituri, fuqi, ushqim e rehati, detyrë e tij është që këtë ta ndajë me të tjerët. Nëse ndonjëri arrinë mirëqenie, sukses apo përparim, është detyrë e tij t’u ndihmojë të tjerëve që edhe ata t’i arrijnë të njëjtat.⁷ Ai është një rend i qenieve njerëzore që vendosin ta qeverisin jetën e tyre dhe të gjithë njerëzve të tjerë sipas vlerave dhe parimeve të *ummetit*. Ata mund t’u takojnë viseve e bashkësive të ndryshme. Anëtarësimi i tyre në *ummet*, *Sheri’atit* i jep autoritetin e plotë mbi dallueshmëritë e tyre. *Ummeti* nuk mbështetet as në racë, as në territor, as në gjuhë, as në sovranitet politik e ushtarak e as në histori të shkuar. Ai mbështetet në fenë Islame. Secili që vendos Islamin ta marrë si fe të veten dhe ta drejtojë jetën e tij sipas ligjeve të Islamit, *ipso*

* Ky është kapitulli X i librit *Tevhidi – implikimet e tij mbi mendimin dhe jetën (Al-Tawhid – Ist Implications for Thought and Life)* të autorit Ismail Raxhi el-Faruki, përkth. Rejhan Neziri, bot. Logos-A, Shkup, 2006.

¹ El-Enbija’:92.

² “(Njeriu me siguri është në humbje), përveç atyre të cilët besojnë dhe bëjnë vepra të mira dhe të cilët porosisin për drejtësi dhe i rekomandojnë njëri-tjetrit durim” (el-‘Asr:3); “Por që është prej atyre që besojnë dhe për durim porosisin, dhe për mëshirë këshillojnë” (el-Beled:17).

³ “Të gjithë së bashku mbahuni fort për litarin e All-llahut dhe mos u përçani! Pastaj përkujtojeni dhuntinë e All-llahut ndaj jush kur ishit të armiqësuar e Ai i bashkoi zemrat tuaja dhe ju me mëshirën e Tij u bëtë vëllazër. Ishit buzë greminës së zjarrit e ju shpëtoi prej tij. Ashtu All-llahu jua shpjegon argumentet e Veta, ndoshta merrni të mbarën” (Alu ‘Imran:103).

⁴ “Dhe le të ketë nga ju një **ummet** që do të thërasë në të mira dhe të kërkojë të bëhen punë të mira dhe të pengojë nga veprat e këqija! Ata do të jenë të shpëtuarit” (Alu ‘Imran:104).

⁵ “Nderojeni All-llahun dhe Pejgamberin e Tij, nëse vërtet jeni besimtarë!” (el-Enfal:1).

⁶ “Më fisniku prej jush tek All-llahu është ai i cili më së shumti i ruhet Atij (më i devotshmi)” (el-Huxhurat:13).

⁷ “Ndihmoheni njëri-tjetrin në bëmirsësi dhe devotshmëri dhe mos e ndihmoni në mëkat dhe armiqësi!” (el-Maideh:2).

facto, bëhet anëtar i *ummetit*. Ky është kuptimi i kërkesës juridike të *Shehādetit*. Nuk nevojitet ndonjë kërkesë tjetër. Duke e zgjedhur këtë opcion, secili person e autorizon vetveten që t'i ushtrojë të gjitha të drejtat, t'i gëzojë të gjitha privilegjet dhe t'i marrë të gjitha detyrat që i parasheh *Sheri'ati*.

Individi musliman mund të jetojë kudo në tokë dhe mund t'u mbetet besnik ligjeve tokësore përderisa ato nuk bien ndesh me *Sheri'atin* në fushat që kanë të bëjnë me jetën e tij. Po qe se ligjet e vendit ku ai jeton, në jetën e tij ndikojnë në mënyrë të kundërt me Islamin, atëherë ai ka të drejtë të vendosë për emigrimin në ndonjë vend islam apo ta bartë efektin e kundërt në jetën e tij me shpresë se do t'i arrijë synimet e mëtejme, të fshehta, qofshin këto islame apo të ndryshme. Islami nuk është i obliguar të ndërhyjë në emër të tij. Megjithëkëtë, është detyrë e çdo individi musliman që t'i ftojë të tjerët në Islam dhe të kërkojë krijimin e *ummetit* në vend; është detyrë e tyre të kërkojnë shpalljen e *Sheri'atit* si ligj të vendit ku jetojnë.

I. TEVHIDI DHE HILAFETI

Ummeti, siç u përkufizua më lart, është faktor i rindërtimit apo i reformimit të botës për ta plotësuar vullnetin hyjnor. Ai është *halif* i Zotit të krijesat, sepse kjo veti, që burimisht i është dhënë njeriut, duhet të shtrihet te i tërë *ummeti* për arsyet e përmendura në pjesën e mëparshme. *Ummeti*, po kështu, është dhe shtet, në kuptim të sovranitetit, me gjithë organet e fuqitë që i kërkon ushtrimi i këtij sovraniteti. Si shtet, *ummeti* do të duhej të referohej jo si *devlet*, por si *hilāfet*. Ky i dyti është më i afërt me traditën islame dhe me *tevhidin*, pasi është një deduktim i tij i drejtpërdrejtë dhe kur'anor.⁸ I pari është një nocion modern dhe qëndron shumë larg idesë kur'anore të mëkëmbësisë, e cila është *raison d'être* e vërtetë e *ummetit*. Ndonëse e nënkuptojmë shtetin kur e përmendim kalifatin, megjithëkëtë duhet ta sjellim ndër mend dallimin e dukshëm midis nocionit perëndimor të shtetit dhe *ummetit*. Për këtë arsye, kalifati është *ummet* për aq sa ka të bëjë me ushtrimin e sovranitetit të *ummetit* që është përbërëse, megjithëse jo aq ekskluzive, e mëkëmbësisë së *ummetit*. Duke e analizuar *hilāfetin*, propozojmë t'i analizojmë edhe implikimet e *tevhidit* lidhur me teorinë politike.

Hilāfeti është një konsensus i trefishtë. Ai është konsensus i vizionit, i fuqisë dhe i punës.

A. IXHMĀ'UR-RU'JEH

Ixhmā'ur-ru'jeh (konsensusi i vizionit) është një komunitet i mendjes apo i vetëdijes dhe ka tri komponentë. E para është njohja e vlerave, që e përbëjnë vullnetin hyjnor, dhe e lëvizjes, që gjatë historisë e ka prodhuar realizimi i tyre. Është e qartë se ai është sistematik dhe historik. Përmbajtjet e vizionit për nga natyra janë të pafund. Prandaj, nuk është e thënë që ato të përfshihen në tërësi. Ajo çka mund dhe çka duhet të përfshihet është esenca apo

⁸ Është theksuar në ajetet kur'anore ku përmenden termat: **hilāfeh, hulefā, halā'if, jestahlifukum** etj.

thelbi. Kjo është një strukturë, një metodologji e të lidhurit, sistemimit dhe deduktimit e cila, me t'u përvetësuar, mund t'i mundësojë njeriut zbulimin dhe vërtetimin e asaj çfarë i ka ikur gjithpërfshishmërisë. Kjo, në veçanti, është e vërtetë për njohjen sistematike të vlerës, burimet e së cilës janë shpallja – Kur'ani e *sunneti* – dhe arsyeja nëpërmjet së cilës e kuptojmë procesin e saj (logjikën dhe epistemologjinë), realitetin në përgjithësi (metafizikën), natyrën (shkencat natyrore), njeriun (antropologjinë, psikologjinë dhe etikën) dhe shoqërinë (shkencat shoqërore). As në rastin e shpalljes, as në të arsyes nuk kërkohet që vizioni të jetë akademik, i përbërë prej një konceptualizimi të sistemuar të përmbajtjes; por të jetë intuitiv, pra, që e shijon dritën perceptivë e cila mund të shndrisë çdo fushë duke krijuar për vizionin një imazh të rëndësishëm që ka Islami për të.⁹

Njohja e lëvizjes në histori, realizimi i vlerave islame që ajo i ka shkaktuar, para së gjithash, në një krah është punë empirike.¹⁰ Kjo është arsyeja pse muslimanët e hershëm vazhdimisht e kanë ushqyer vetveten me njoftime rreth Pejgamberit a.s. dhe me anekdota të përzgjedhura nga jeta e shokëve të tij. Ky lloj nevojë e shoqëron çdo bashkësi fetare, sepse ka një rëndësi vendimtare për ithtarët e tyre që, nga të kuptuarit spekulativ i besimit të tyre të kalojnë në njohjen se si ai mishërohet në konkretin. Materialet e pjesshme të realizimit të vlerës, mbi studentët e tyre ushtrojnë një ndikim pedagogjik të vlefshëm e të dëshirueshëm dhe janë më lehtë për t'u kuptuar e mbajtur mend sesa përmbajtjet e studimit sistematik. Megjithatë, të dyja janë njësoj të domosdoshme për krijimin e vizionit të nevojshëm për *hilāfetin*.

Një vizion i kompozuar edhe prej perceptimit sistematik të vlerave edhe prej mishërimeve të tyre historike, mbetet akoma i pakompletuar pa njohjen e së tashmes dhe si kjo e tashme mund t'i realizojë ato sërish. Meqë *hilāfeti* nuk mund të shikojë prapa, porse duhet të jetojë e veprojë në të tashmen e në të ardhmen, atij i duhet që vlerat t'i lidhë me të tashmen dhe të përcaktojë cilat materiale të vërteta cilat vlera do t'i realizojnë, në ç'mënyrë kushtet e tanishme ndikojnë në sistemin e renditjes së vlerave me detyrë që t'i realizojnë ato.

Ixhmā'ur-ru`jeh, siç e përkufizua këtu, supozohet të jetë burim i njohjes fetare. *Hadithi* i Pejgamberit a.s. "*Ummeti* im nuk do të arrijë konsensus për gjëra të gabueshme", *vox populi* të *ummetit* ia ka bashkëngjitur një frymë thujse shenjtërie. Megjithëkëtë, ai nuk është dogmatik, por gjithnjë mbetet i hapur.¹¹ Kjo hapshmëri është institucionalizuar te *ixhtihādi*, që është aftësia – bile edhe detyra – e çdo muslimani të ndërjegjshëm për ta përvetësuar sërish gjithë apo një pjesë të vargut të të vërtetave e vlerave të Islamit. Për nga natyra *ixhtihādi* është dinamik dhe kreativ si dhe mjaft tërheqës për mendjen perceptuese. Gjithashtu edhe Pejgamberi a.s. e ka pa të udhës që atë ta bekojë me *hadithin* "Kushdo që bën *ixhtihād* dhe nuk ia qëllon, ai fiton një masë të vlerës morale. Kushdo që bën *ixhtihād* dhe ia qëllon të vërtetës, ka fituar dyfish". *Ixhtihādi* bashkë me *ixhmānë* përbëjnë një lëvizje dialektike e cila e përbën dinamizmin e Islamit në botën e ideve. Sepse, megjithëse *ixhmāja*

⁹ "Dhe le të ketë nga ju një **ummet** që do të thërasë në të mira dhe të kërkojë të bëhen punë të mira dhe të pengojë nga veprat e këqija! Ata do të jenë të shpëtuarit" (Alu 'Imran:104).

¹⁰ Kjo vëmendje ndaj konkretes dhe implementimi i kushteve të saj është ajo që Islamit ia ka përfutur famën e tij si fe praktike – **orthopraksë** – dhe në mënyrë të ashpër e ka vënë atë përballë feve të utopisë.

¹¹ Në Islam, **vox populi** asnjëherë nuk është identifikuar me **vox dei**-n. Për më tepër, ai absolutisht i është nënshtruar urdhrit të All-llahut xh.sh., është çmuar kur është pajtuar me të dhe është qortuar e dënuar kur është penguar prej tij.

shenjtërohet si kurorëzim i përpjekjes për të kuptuar, ajo gjithnjë thyhet nga energjia krijuese e *ixhtihādīt*; dhe, megjithëse *ixhtihādi* shenjtërohet si qëllim shumë i lartë i dëshiruar i të kuptuarit, ai matet, spastrohet dhe kritikohet nga domosdoshmëria për t'i bindur të gjithë muslimanët e tjerë për vlefshmërinë e zbulimeve të tij – nga nevoja për t'u aprovuar nga të gjithë (*el-ixhmā*).

B. IXHMĀ'UL-IRĀDEH

Konsensusi i fuqisë është një komunitet i vullnetit dhe ka dy komponente: e para, *el-'asabijeh* (*sensus communis*, kohezioni shoqëror), me anë të të cilit muslimanët zotohen se do t'i përgjigjen çdo ngjarjeje e situatë në një mënyrë të vetme, me bindjen e bashkuar ndaj thirrjes së Zotit; dhe e dyta, *en-nidhām* (pajisja organizuese dhe logjistike që ka mundësinë ta kristalizojë vendimin, t'i pasurojë e mobilizojë muslimanët në plotësimin e thirrjes dhe të bëjë realizimin e vlerave për individët, grupet dhe liderët e tyre).

'Asabijeti nuk është ekuivalent apo pasojë e konsensusit të vizionit. Ai mund dhe duhet të pasurohet e të thellohet nga konsensusi i tillë. Në fakt, ai s'mund të bëjë pa këtë konsensus, sepse atje ku asgjë nuk mbahet e përbashkët, asnjëherë s'mund të gjendet ndonjë kohezion. *'Asabijeti* kërkon më tepër se konsensusin e vizionit. Ai e shpreh vetveten në një vendim për t'u identifikuar me lëvizjen, për ta lidhur fatin, si të thuash, me anijen e *ummetit*, e pastaj për t'u përgjigjur, pra për t'i thënë e bërë një "po" pozitive thirrjes dhe gjithë çfarë kërkon thirrja. Vetë vendimi bazohet në një proces të gjatë të transformimit psikik gjatë të cilit individ i identifikon vetveten me *ummetin*, por në fund të të cilit vetëdija e tij i kthehet implementimit dhe e identifikon vetveten me *hilāfetin* si vorbull historik i *ummetit*. Ky proces psikik mund të jetë lëndë e arsimit dhe e pedagogjisë. Kudo që të jetë, duhet të rafinohet e të pasurohet. Mirëpo, ai mund të shfaqet në mënyrë të natyrshme nëpërmjet lindjes e të ushqehet në lagjen e mbyllur të fisit, me ç'rast do të rritet si një shtytje fanatike dhe e verbër për t'u identifikuar me fisin a racën. Në këtë kuptim, Ibni Halduni e pati shpallur këtë për bazë të kohezionit shoqëror.¹² Meqë në Islam këto elemente materiale janë tejkualuar në favor të ideologjisë së *tevhidit*, *'asabijeti* i Islamit do të duhej të ishte rezultat i një procesi të ri, i një *paideia* të re (një transfigurim aktiv dhe i vazhdueshëm i vetvetes në imazhin që e ka dëshiruar Zoti). Për këtë arsye, *'asabijeti* duhet të dëshirohet, të ushqehet, të zhvillohet e të piquet. Ai nuk mund të jetë vetëm një rritje e pavullnetshme për nga natyra, as të ngatërrohet me ndjenjën nacionaliste të romantizmit evropian, i cili shpesh përshkruhet si i pandërgjegjshëm, i pamatur, i brendshëm dhe i errët në masë të pashpjegueshme, i cili sërish është vërtet *'asabijet* i tribalizmit. *'Asabijeti* islam është i matur, qartë i shpjegueshëm si një akt etik dhe i përgjegjshëm. Ai nuk është një zotim, një angazhim për fatin e *ummetit* në dritën e qartë të *tevhidit*, në dritën e plotë të radhitjes së tërësishme të kuptimeve sipas *tevhidit*. Në formën më të pastër ai ilustron në klithjen korale të haxhilerëve në Mekke gjatë sjelljes rrethepërqark Qabesë apo gjatë nxitimit të tyre drejt Arafatit: *Lebbejk All-llāhumme lebbejk!* ("Të përgjigjem Ty, o Zot! Të përgjigjem!").

¹² Abdurrahman ibni Haldun, *el-Mukaddimeh*, Kajro: Matba'atu Mustafa Muhammed, p.d., f. 127 e tutje.

Kurse kjo është në kundërshtim të dukshëm me partikularizmin e krahinizar dhe / apo të racializuar a të kulturizuar, ashtu siç ka qenë gjatë shekujve nacionalizmi perëndimor.¹³

Duke qenë se është një element përbërës i *ummetit* universalist, që e mbulon një pjesë të gjerë të globit, *'asabijjeti* nuk mund të jetë një fakt thjeshtë personal i muslimanit. Po as që mund të funksionojë si një dallgë e lirë të cilën muslimani e dëshiron apo e duron për të vepruar në përgjigje të situatave e ngjarjeve. Ky do të ishte një kaos me dimensione globale. Me qëllim që të jetë islamik dhe përgjegjës, *'asabijjeti* duhet të formohet në mënyrë që të përputhet me atë të të gjithë muslimanëve të tjerë në ritëm, intensitet, drejtim dhe për ta transformuar vetveten në veprim kooperues me muslimanët e tjerë. Ky është aspekti i *nidhāmit*, për të cilin institucioni i *ixhmasë* e ka përgatitur aftësinë e të kuptuarit të muslimanëve për kuptimet e domethëniet e *tevhidit*. Duke patur për qëllim *nidhāmin*, paraardhësit tanë e kanë ditur mirë se çdo musliman duhet të jetë i shkolluar dhe letrar, se duhet të dijë pjesë të mëdha të Kur'anit, të jetë i njohur me *sīran* e Pejgamberit a.s. dhe me *sijerin* e shokëve të tij, se duhet shpesh ta vizitojë *xhemā'atin* që e ka afër shtëpisë dhe t'i kryejë adhurimet (pra, të bashkëpunojë e të shërbejë me ta në emër të Zotit) në xhaminë fqinje. Kërkesa që me rastin e adhurimit (namazit) shpatullat e muslimanëve ta prekin njëra-tjetrën, ka patur për qëllim t'ua mundësojë atyre praninë e gjallë të njëri-tjetrit, vetidentifikimin reciprok dhe bashkëpunimin, në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës, me *ummetin* në përgjithësi, të ngulet në vetëdijen e adhuruesit njohja e All-llahut si Zot dhe Krijues. E gjithë kjo do ta përgatiste skicën bazë për organizimin e institucionalizuar të *hilāfetit*. Xhamia asokohe ka qenë, ashtu siç duhet të jetë edhe sot, strumbullari i aktivitetit islam, qendra e makinerisë logjistike e Islamit, sepse në të muslimani e ka bërë daljen/shfaqjen ditore, ka vënë kontakt të drejtpërdrejtë me miqtë e tij nën patronazhin e *tevhidit* dha ka marrë racionin ditor të vitaminës shpirtërore, morale dhe politike. Kësaj të fundit është dashur t'i jepet dhe në fakt i është dhënë e njëjta vlerë e lartë në përputhje me *ixhtihādin* nga ana e ndonjë muslimani të motivuar nga njohja dhe urtësia e tij më e mirë për t'i ftuar shokët e tij, pa e përjashtuar as vetë halifin, në plotësimin e urdhrit hyjnor: "Thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillime të mira dhe diskuto me ta në mënyrë të mirë!"¹⁴ dhe të idesë së Pejgamberit a.s. lidhur me mbështetjen e *nasihatit* (këshillës së dhënë në mënyrë të lirë).¹⁵ Ky kontakt dhe kjo ndërlihdje me të tjerët do ta arrijë kulmin në namazin e *xhumasë*, ku fjalimi i *imāmit* që përbën shtyllën kryesore të tij. Kjo *hutbeh* (fjalim), ka të bëjë me situatën e përditshmërisë, me problemet sociopolitike dhe ekonomike me të cilat ndeshet shoqëria muslimane. Kushti që *hutbeja* të përfshijë dhe disa referime nga Kur'ani dhe *hadithi*, nënkupton sjelljen e urtësisë islame që të flasë për situatën aktuale dhe me këtë ta shprehë rëndësinë e tij. Përfundimisht, praktika sipas së cilës *'āmili* (qeveritari) është *imām* në namazin e *xhumasë*, nënkupton kristalizimin, me qëllim ekzekutimi, e konsenzusit të dalë nga diskutimet e këshillimet e javës apo edhe ta reflektojë mosarritjen e konsenzusit; nënkupton furnizimin e udhëheqësisë rreth së cilës mblidhen

¹³ Shih veprat e autorit, *Christian Ethics*, kapt. I, VII; *Urūbah and Religion*, f. 206 e më tej.

¹⁴ En-Nahl:125.

¹⁵ Duke e promovuar kritikën e ligjshme ndaj udhëheqësit, Pejgamberi a.s. ka thënë: "Cildo që e humb jetën duke kërkuar llogari prej udhëheqësit vdes si dëshmor" dhe "Nëse një popull është dëshmitar për sjelljen tirane të udhëheqësit dhe nuk ndërmerr asgjë për ta penguar atë, bëhet bashkëfajtor në mëkatën e dënuar rëndë nga All-llahu xh.sh."

njerëzit, sigurimin dhe testimin e *dénouchmentit* të nevojshëm për çështjet aktuale. Sipas Islamit, transformimi aktual i tokës dhe i njerëzve për hir të të cilit është shpallur Kur'ani,¹⁶ shërbimi konkret i bujkut qiramarrës në pronën e Zotit që është toka, e jo përshpirtësitë fizike akrobatike të murgut në mes të shkretëtirës, si guru i Upanishadave, e as vetëndëshkimi, mohimi i botës dhe përçmimi i historisë nga ana e asketëve të cilësdo traditë fetare, të gjitha këto konsiderohen si adhurim (ndaj Zotit).

C. IXHMĀ'UL-'AMEL

Ixhmā'ul-'ameli, me këtë rast, është kulmi i të gjitha përgatitjeve të mëparshme. Ai e vë në jetë kristalizimin e obligimeve që dalin nga *ixhmāja*; është një proces i cili, sikur dinamizmi i përgjithmonshëm i dialektikës së *ixhmāsë* – *ixhtihādit*, asnjëherë s'mund të thuhet se e kufizon dhe, si të thuash, ia jep njeriut të drejtën për në parajsë. Realizimi i vullnetit të Zotit në hapësirë-kohë, për njeriun është një përpjekje të cilën e kufizon vetëm Dita e Gjykimit. Ai përbëhet nga kënaqja e nevojave materiale të *ummetit*, nga ofrimi i një arsimit mjaft adekuat për çdonjërin anëtar të tij me qëllim të sjelljes së një mase të plotë të vetërealizimit dhe nga furnizimi me të gjitha mjetet e nevojshme materiale dhe morale për mbrojtje të suksesshme të *ummetit* nga armiqtë e tij të jashtëm si dhe për shkaktimin e realizimit të vullnetit hyjnor gjithandej botës.

T'i plotësosh nevojat materiale të *ummetit*, është pjesë e thelbit të vullnetit hyjnor, ndaj dhe të fesë. Meqë Zoti e ka krijuar njeriun që t'i shërbejë Atij¹⁷ dhe këtë ta bëjë si një bujk qiramarrës në pronën e Zotit,¹⁸ nga kjo rezulton se Zoti dëshiron që njeriu ta lëvrojë tokën, t'i shfrytëzojë elementet dhe forcat e natyrës e të ngrejë qytetërime sipas kënaqësisë së tij.¹⁹ Duke e konfirmuar këtë shikim, Kur'ani varfërinë e përshkruan si premtim të shejtanit,²⁰ kurse ushqimin e të uriturit dhe mbrojtjen e të dobëtit i identifikon me vetë fenë.²¹ Është pasoja e mëkëmbësisë së njeriut ajo që atij ia mundëson shijimin e ëmbëlsive dhe kënaqësive të botës, sidomos nëse ai e ka kryer detyrën e shërbimit ndaj Zotit.²² Sipas

¹⁶ "All-llahu nuk e ndërton një popull derisa ata nuk e ndërrojnë vetveten" (er-Ra'd:11); "Ata të cilët, nëse u japim pushtet në tokë, do të kryejnë faljen dhe do të japin sadakë, do të urdhërojnë të bëhen vepra të mira dhe do të largojnë nga veprat e këqija. Ndërkaq përfundimi i çdo sendi i takon All-llahut" (el-Haxhxh:41).

¹⁷ "Dhe nuk i kam krijuar xhinët dhe njerëzit për tjetër gjë pos që të më adhurojnë" (edh-Dharijat:56).

¹⁸ "O populli im! Adhurojeni All-llahun, ju nuk keni tjetër Zot përveç Atij! Ai ju krijoi nga dheu dhe ju vendosi të jetoni në të. Prandaj kërkon falje dhe shprehni pendimin Atij, sepse Zoti im është me siguri afër dhe përgjigjet!" (Hud:61).

¹⁹ "All-llahu premtim se ata që kanë besuar dhe bënë vepra të mira, nga mesi juaj, pa dyshim do t'i bëjë mëkëmbës në tokë, ashtu siç i ka bërë mëkëmbës ata para tyre, dhe se do t'ua forcojë, me siguri, fenë e tyre, atë fe të cilën ua pëlqen Ai, dhe pa dyshim frikën do t'ua zëvendësojë me siguri. Ata do të më përulen Mua dhe nuk do të më bëjnë tjetër shok. Ndërsa ata që edhe më, pas kësaj, më mohojnë – ata janë, vërtet, maskarenj" (en-Nur:55).

²⁰ "Djali ju premtim varfëri dhe ju urdhëron të bëni paudhësi, por All-llahu ju premtim falje dhe mirësinë e Tij. All-llahu është me dijeni të gjerë" (el-Bekarah:268).

²¹ "A e pe atë i cili e përgënjeshtron atë botë (fenë)? Po ai është i cili e refuzon ashpër bonjakun dhe nuk e ndihmon të varfrin në ushqim" (el-Ma'un:1-3).

²² "Thuaj: 'Kush i ka ndaluar stolitë e All-llahut dhe ushqimet e mira, të cilat Ai i ka bërë për robërit e vet?' Thuaj: 'Këto janë për ata që kanë besuar (Zotin) në këtë botë dhe të veçanta për ta Ditën e Kijametit'. Ja, ashtu Ne ua shpjegojmë argumentet njerëzve që dinë" (el-A'raf:32).

vizionit mesopotamian, edhe vetë akti i krijimit të njeriut e ka vënë atë në pronën e Zotit si shërbëtor të Tijin. Po ky akt në të njëjtën kohë ishte dhe zanafillë e agrikulturës së organizuar, e ngritjes së digave a kanaleve për ujitje dhe drenazhim (kullim), e *zigurratit* për mbledhjen dhe vjeljen e të korrave, e shpikjes së shkrimit dhe mbajtjes së regjistrimeve dhe, përfundimisht, e ngritjes së mekanizmave qeverisës të fshatit, qytetit, provincës, kombit dhe botës mbarë. Shkurt thënë, akti i krijimit ka qenë vetë nxjerrja e botës nga kaosi dhe vendosja e kozmosit.²³

Mendja semite asnjëherë s'ka mund ta kuptojë mohimin e botës dhe sflitjen e asketit. Seksin dhe lindjen, ushqimin dhe mirëqenien, kurrë s'i ka konsideruar si thelbësisht të këqija. Sipas shikimit të tyre, e keqe është quajtur shpërdorimi i tyre, e jo vetë ato si fenomene të natyrës. Ka qenë trashëgimia gnostike, e përcjellë nga Krishterimi, me gjithë llahtarinë e saj të materies, ajo e cila i ka injektuar në lëvizjen krishtere farat e asketizmit e të mohimit të botës. Është e vërtetë që Islami porosit agjërimin; mirëpo ai këtë e bën për dy qëllime: ushtrimin e vetëpërmbytjes dhe marrjen pjesë në hallet e skamnorit. Në të njëjtin ajet, ai gjithashtu urdhëron që agjërimi të priset në perëndim të diellit me bollëk të ushqimit, pijes dhe marrëdhënieve intime.

Sa janë nevojat materiale të njeriut që duhet t'i plotësojë halifi për ta përmbytur atë që pritet prej tij? Është lehtë për ta caktuar minimumin - ky është niveli në të cilin uria, sëmundja dhe morali i papjekur do të mund të eliminoheshin për mbarë njerëzimin. Është e pamundshme të caktohet maksimumi, pasi nuk mund të determinohen as shfrytëzimi i natyrës e as fuqitë frytdhënëse të natyrës. Të dyja këto janë funksione të një zotërimi gjithnjë në zgjerim të ligjeve apo modeleve të natyrës që Zoti i ka mbjellë në të për të mirën e njeriut.²⁴Gjithë çfarë ka në qiell e në tokë, na thotë Kur'ani, është për dobinë e njeriut. Pejgamberi a.s. ka thënë: "Kushdo që bie të flejë natën në shtëpi, kurse një njeri i vetëm larg sa kap udhëtimi brenda një dite është i uritur, ai e ka ofenduar Zotin", kurse Umeri r.a., halifi i dytë, ka deklaruar: "Kam frikë se Zoti do të më mbajë përgjegjës në Ditën e Gjykimit për çdo një mushkë që pengohet apo rrëzohet në këmbësoren e parregulluar, qoftë edhe në largësitë më të mëdha të vendit".²⁵

Pa dyshim që Islami e ka urdhëruar lëmoshën si çdo fe tjetër. Duke e quajtur *sadakah* (fjalëpërfjalë: pjesë e besnikërisë, lëmoshë) ka dashur që atë ta krijojë si tregues dhe shprehje të besnikërisë së besimit të njeriut. Mirëpo, përtej të gjitha feve, Islami e ka theksuar *zekatin*, që është një taksë vjetore prej 2.5 % të pasurisë që tubohet nën sanksion të së drejtës publike. Duke e quajtur këtë *ez-zekāh* (ëmbëltrim) ka dashur të theksojë se pasuria jonë mund të priset e tharohet brenda vitit në qoftë se nuk e ndajmë atë me miqtë tanë. Më tej, ai e siguron skamnorin se atij nuk i takon lëmosha, as një thërrmijë e vogël e vuajtjes, porse e drejta, hisja që ka në pasurinë e pasanikut.²⁶ Islami e ka ndaluar ushtrimin e monopolit dhe mbajtjen e mallit në rezervë, kurse interesin (kamatën) e ka suprimuar si

²³ Pritchard, *Ancient Near Eastern Texts*, f. 60.

²⁴ "Dhe (Zoti) jua ka nënshtruar çka ka në qiej dhe në tokë. E tëra është prej Tij. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë" (el-Xhathijeh:13); "Ai është i Cili jua ka bërë tokën të përshtatshme, andaj ecni nëpër të dhe ushqehuni me furnizimet e Tij. Pas ringjalljes tek Ai shkohet" (el-Mulk:15).

²⁵ Muhammed Husejn Hejkel, *El-Fārūk 'Umar*, Kajro: Matba'atu Misr, 1364 h., vëll. 2, f. 200.

²⁶ "Kurse në pasurinë e tyre kanë pjesë edhe ata që lypin edhe ata që nuk lypin" (edh-Dhariyat:19).

instrumentin kryesor të eksploatimit të njeriut nga njeriu.²⁷ Nga ana tjetër, Islami e urdhëron njeriun që ta kërkojë bujarinë (të mirat) e Zotit gjithandej nëpër tokë,²⁸ të dalë e të emigrojë në kërkim të asaj bujarie – në fakt të kërkojë “milionin” por nën ligjin moral të Zotit, pra pa tradhti, pa mashtrim, pa vjedhje e pa plaçkitje. Dhe sapo të fitohet e tubohet “milioni” a ndonjë pjesë apo shumëfishi i tij, duhet të ëmbëltohet me *zekat*, kurse “besnikëria” e pronarit të tij të provohet me *sadaka*.²⁹ Natyrisht që është detyrë e *hilāfetit* që të bëjë çmos për t’ia mundësuar çdo anëtari të *ummetit* fitimin dhe gëzimin e bujarisë së Zotit në tokë. Mirëpo ky synim, sado fisnik dhe i domosdoshëm, shpejt mund të shkarëzohet në shtazëri të pagdhundur e në nënvleftësim, që është një çoroditje e personalitetit të njeriut dhe tradhti e mbarë vullnetit hyjnor, sapo të konsiderohet si qëllim i vetëm dhe final i jetës njerëzore.³⁰ Nevojat materiale të jetës janë të pafajshme dhe, në fakt, të mira; ato duhen plotësuar sa më shumë që të jetë e mundur. Mirëpo, ato dhe i gjithë aspekti material i jetës që po e mbështesin janë vetëm mjete, instrumente, bartëse të shpirtërores, qoftë për individin, qoftë për *ummetin* mbarë. Ndjekjet dhe kërkimet materiale t’i mbash për qëllime finale do të thotë ta mohosh shpirtëroren.

Kjo do të thotë të pretendosh se shpirtërorja është jetë e zbrazët, e çmishëruar e ritualit dhe e vetëtransformimit psikik, si një alternativë ndaj jetës së kërkimit material. Jeta shpirtërore në Islam ka tri shkallë / faza që duhen ndjekur të gjitha përnjëherë. E para është angazhimi i individit në çështjet e përgjithshme materiale të *ummetit*. Kjo është detyra e nënshtrimit të nevojave personale të individit ndaj kërkesave të punës së *ummetit*. E dyta është ndjekja e arsimit për vete dhe për të tjerët në një nivel të dyfishtë, d.m.th., që zotërimi i natyrës ta bëjë më të mundshëm e më të lehtë shfrytëzimin e saj nga ana e njeriut dhe që dialektika e *ixhmāsë* – *ixhtihādīt* të bëhet më dinamike, më kreative dhe t’i arrijë shkallët më të larta të mundshme të vullnetit hyjnor. E treta është prodhimi i punimeve estetike që e kristalizojnë dëshirën e madhe, aspiratat dhe vrullin e *ummetit*, në mënyrë që *ummeti* të vazhdojë t’i aktualizojë e t’i mishërojë vlerat apo vullnetin hyjnor në histori.

Komponenti i dytë i *ixhmāsë-ixhtihādīt* (konsenzusit të prodhimit) është ofrimi i arsimit për të gjithë anëtarët e *ummetit* për së gjeri dhe së larti, ku do të mund të arrihet shkalla e plotë e vetërealizimit.³¹ Asnjë individ nuk do ta ketë realizuar misionin e tij si shërbyes i Zotit në qoftë se potenciali i tij personal nuk zhvillohet e hapet deri në pamundësi. Një individ i tillë jo vetëm që nuk do të ndjehet i lumtur dhe një *ummet* i përbërë prej të tillëve individë jo

²⁷ “(Vaj halli për atë) i cili grumbullon pasuri dhe e numëron; dhe mendon se pasuria e tij do ta bëjë të pavdekshëm” (el-Humezeh:2-3); “Mirëpo All-llahu e ka lejuar tregtinë dhe e ka ndaluar kamatën...” (el-Bekareh:275).

²⁸ “Dhe pasi të kryhet namazi shpërndahuni nëpër tokë dhe kërkoni mirësitë e All-llahut dhe përmendeni All-llahun shpesh, ndoshta do të shpëtoni!” (el-Xhumu’ah:10).

²⁹ “Merr zekatin nga pasuria e tyre që t’i pastrosh me të e t’i bësh të bekuar dhe lutu për ata se lutja me të vërtetë do t’i qetësojë! Ndërkaq All-llahu dëgjon dhe di shumë” (et-Tevbeh:103). Ajetet ku’anore që urdhërojnë **zekatin** janë të shumënumërta. Shih Berakati, *El-Murshid...*, s.v. **zekāh**.

³⁰ Në fakt, kërkimi dhe ndjekja e një vlere duke i përjashtuar vlerat e tjera, përbën një tirani apo monopol të asaj vlere. Një ndekje e këtillë e stërmadhuar e prish përpjekjen si dhe qëllimin e saj dhe i shndërron ato në diçka të pavlerë.

³¹ “Lexo, në emër të Zotit tënd i Cili ka krijuar...Lexo, se është fisnik Zoti yt, i Cili e mësoi me pendë, i mësoi njeriut çka nuk kishte ditur” (el-’AleK:1-5); “Të gjithë besimtarët nuk duhet të shkojnë në luftë. Disa prej tyre, nga secila bashkësi, le të paraqiten të marrin rrugën e shkencës fetare dhe le t’i tërheqin vërejtjen popullit të vet kur të kthehen nga lufta, ndoshta ata dotë ruhen” (et-Tevbeh:122).

vetëm që do të jetë një shoqëri e frustruar (e zhgënjyer), por tundimi për të kërkuar vetërealizimin jashta kufijve të *ummetit* apo komploti për ta minuar dhe sabotuar *hilāfetin* do të vazhdojë t'u fanitet talenteve të papërdorura, energjive të pashfrytëzuara dhe shpirtrave të zbrazët. *Hilāfeti* duhet t'i bëjë të dyja: T'i krijojë nevojat, pra ta ngacmojë potencialin e fshehur tek anëtarët, dhe t'i ofrojë mjetet për vetëplotësimin e tyre. Nëse dështon në të parën, para vetes do ta gjejë një *ummet* të përbërë prej njerëzve injorantë e të pazgjuar. Nëse dështon në të dytën, atëherë do t'i ketë hapur dyert e vetëzbrazjes dhe vetëshkretimit nëpërmjet emigrimit, apo të vetëshkatërrimit nëpërmjet subverzionit të brendshëm dhe të luftës e të eksploatimit të huaj nga jashtë. *Hilāfeti* duhet që, për ta plotësuar konsenzusin e podhimit, ta mobilizojë *ummetin* për ta siguruar gjithë atë që është e domosdoshme për një mbrojtje efektive të *ummetit* nga sulmet e armiqve të tij.³² Asnjëri prej anëtarëve nuk është vullnetar; të gjithë janë rekrutë në luftën kur rezikohet vetë ekzistenca e *ummetit* apo kur çështja e ngritjes së fjalës së Zotit mbi çdo gjë në botë kërkon shërbimet e tyre.

Tekefundit, është kjo anë e *ixhmā'ul-'amelit*, gjegjësisht kontributi i tij në islamizimin e botës, ajo që e përbën lumturinë më të lartë të *ummetit*. Është ky aspekt i prirjes dhe i misionit të tij që *ummetin* e ngre në nivelin e garimit në historinë njerëzore e botërore. Arritja e këtij niveli përbën justifikimin final të *ummetit* në syrin e Zotit, *sub specie eternitatis*.

II. TEVHIDI DHE PUSHTETI POLITIK

A. ISLAMI DHE BOTA MUSLIMANE: FAKTET E HIDHURA

Bota muslimane e cila tani numëron tepër se një miliard anëtarë që banojnë në një hapësirë që shtrihet që nga Lindja e Atlantikut e deri në Paqësor, e që tani ka filluar të lëshojë rrënjë e të përhapet edhe në Evropë e Amerikë, përbën një potencial shumë të madh për lartësimin e fjalës së Zotit në botë. Për fatin e keq të vetin e të botës, ajo është akoma larg zhvillimit apo hapjes së aftësive të saj në interes të kauzës së Zotit. Në të vërtetë, ajo është duke mbajtur një baraspeshë shumë të pasigurt midis përdorimit të aftësive të saj për zhvillimin e vetë dhe shkretimit të këtyre aftësive në përpjekje të kota për shtëpinë dhe në përpjekje konstruktive për dobitë e jomuslimanëve.

Shumica dërmuese e kushtetutave të shteteve muslimane deklarojnë se Islami është fe shtetërore e tyre. Vetëm njëra, Arabia Saudite, këtë deklaratë e merr përnjëmend, për çka na tregon implementimi i *Sheri'atit*. Një numër shtetesh të tjera, si Pakistani dhe Kuvajti, vijnë me radhë duke pretenduar se Islami është *raison d'être* e shtetit dhe e *ummetit*, mirëpo kësaj i shtojnë edhe nocionet deskriptive të Perëndimit sipas të cilave ato janë

³² "Dhe kundër tyre (armiqve) përgatitni sa të mundeni forcë e kuaj për betëj, që t'i tmerroni me këtë armiq të All-llahut dhe të tuajit si dhe të tjerët të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e të cilët i di All-llahu! Çkado që të shpenzoni në rrugë të All-llahut, ajo do t'ju kompensohet dhe nuk do t'ju pëhet e padrejtë" (el-Enfal:60).

kombe apo shtete, sepse e kombinojnë një popull, një territor dhe suverenitetin – një gjykim ky i cili në çast pranon se Islami nuk është i përshtatshëm si *raison d'être*. Grupi i tretë i vendeve, si Egjipti, Maroku, Sudani etj., Islamit e konsiderojnë si kremë të domosdoshme mbi ëmbëlsirën, struktura dhe thelbi i brendshëm i së cilës më tepër është modeluar sipas nocioneve perëndimore sesa sipas atyre islame. Nacionalizmi, një *shu'ubijeh* e re, duke e imituar damkën perëndimore të romantizmit (*Blut und Boden*), i përcakton ligjet e imigrimit e të natyralizimit, politikën aktive të liderëve, stilin e jetës së inteligjencies e të elitës tjetër dhe vetimazhin shoqëror që është projektuar për arsimimin dhe inspirimin e vegjëlisë. Nuk ekziston asnjë vend musliman që vetveten e mban në mobilizim dhe vigjilencë të vazhdueshme në të cilën shoqëria e Pejgamberit a.s. e kishte vënë vetveten gjatë gjithë periudhës së qeverisjes së Tij në Medine. Dhe, ndoshta veçoria më e keqe e botës muslimane është falimentimi i saj në fushën e arsimit. Askund nuk ekziston as një institut i vetëm i cili do ta merrte mbi vete barrën e strehimit të një muslimani pesëvjeçar dhe t'ia dorëzonte prapë *ummetit* me potencial të zhvilluar në tërësi. Ne nuk kemi mjete ndihmëse që do ta kryenin detyrën e trajnimit të muslimanit i cili do ta transformonte botën dhe do t'i përngjasonte sendet me modelet hyjnore duke qenë i vetëdijshëm për vetë modelet hyjnore si synim final i ekzistencës së tij personale. Përqindja e emigrantëve të arsimuar dhe e vendasve të frustruar krahasuar me numrin e përgjithshëm të doktorëve të filozofisë apo të shkencave të mjekësisë dallon në shkallë të lartë tmerruese. Në skajin tjetër të spektrit, përqindja e analfabetëve ndaj të shkolluarve është tronditëse.

Nuk është shqetësues fakti se muslimanët po zgjohen nga gjumi i tyre i gjatë; se shoqëritë e tyre janë të dobëta në hovin e tyre ekonomik, shoqëror e politik; apo se shtetet e tyre po lëkunden nga plogështia dhe letargjia me ritmin “stakato”. Ajo që të shqetëson është mungesa e vizionit ndër liderët muslimanë lidhur me çështjen e *ummetit* në këtë çast kritik të së tashmes e të së ardhmes. Kjo që po e shohim është pasojë e kësaj mungese të vizionit, kurse kjo nënkupton mungesën e plotë të përpjekjes për të krijuar qytetarin islam, i cili do të jetë i gatshëm që në shekullin njëzet e një të japë çdo gjë për ideologjinë e Islamit.

B. PREMTIMI I PUSHTETIT POLITIK

Asnjë musliman i sinqertë nuk i kupton apo nuk i pranon dot ndjesat e shfajësimet që zakonisht i japin politikanët muslimanë lidhur me të metat e hidhura të *ummetit* të këtij shekulli. Dhe askush s'e pranon dot argumentin sipas të cilit iniciativa e masave duhet të dalë nga shtresat e masave para se ajo të ushtrohet nga ana e liderëve të *hilāfetit*. Elita që di më tepër natyrisht se ekziston, edhe atë me bollëk. Ajo që nevojitet në këtë kohë të historisë është shkëndija për ta vënë në lëvizje vullnetin e *ummetit*. Kjo mund të vijë vetëm nga gatishmëria e liderëve për t'u angazhuar në punën e rrezikshme të ndërhyrjes në histori si subjekt, e jo si pësues dhe objekt i saj.

Ndërhyrja e *ummetit* musliman në histori fillon në shtëpi, në ngritjen e durueshme e të matur të *hilāfetit*, i cili nuk mund të thuhet se ekziston në ndonjë shtet të sotëm musliman. Sapo të sigurohet për një bazë të përkohshme ku do të ankorohet, *hilāfeti* duhet ta mobilizojë mbarë botën muslimane dhe ta ftojë atë për marshim. Asnjë çmim nuk do të dukej i tepërt

për arritjen e këtij synimi, përveç tretjes së vetë *hilāfetit*. Personeli i tij mund dhe duhet të sakrifkohet në qoftë se progresi drejt këtij synimi nuk mund të realizohet pa të. Në momentin kur *ummeti* ta shprehë gatishmërinë e tij, *hilāfeti* i Ebu Bekrit sërish do të jetë prezent, kurse ky do të ishte momenti më i madh i mundshëm.